



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

**PROGRAM LËNDOR PËR ARSIMIN BAZË
PËR FËMIJËT E NGUJUAR**

Lënda: Gjuhë e huaj

Klasat: VI, VII, VIII, IX

Tiranë, 2018



	Emër Mbiemër	Pozicioni	Data	Nënshkrimi
Koordinoi:	L.Stefani	Specialist i Sektorit të Zhvillimit të Kurrikulave dhe Standardeve	___.11.2018	
Pranoi:	D.Rapti	Drejtori i Drejtorisë së Kurrikulës, Standardeve dhe Kualifikimit	___.11.2018	

PËRMBAJTJA E PROGRAMIT LËNDOR “GJUHË E HUAJ”

(klasa VI, VII, VIII, IX- Arsimi për fëmijët e ngujuar)

1	HYRJE	2
2	KORNIZA KONCEPTUALE E PROGRAMIT LËNDOR “GJUHË E HUAJ”	3
2.1	Qëllimet e programit lëndor “Gjuhë e Huaj”	6
2.2	Lidhja e kompetencave kyçe me kompetencat e lëndës “Gjuhë e Huaj”	8
2.3	Rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës “Gjuhë e Huaj”	11
2.4	Lidhja e lëndës “Gjuhë e Huaj” me temat ndërkurrikulare	14
2.5	Lidhja e lëndës “Gjuhë e Huaj” me fushat e tjera kurrikulare	15
2.6	Kompetencat e lëndës “Gjuhë e Huaj”	17
2.7	Rezultatet e të nxënit	19
2.8	Ndarja e orëve mësimore.....	28
3	UDHËZIME METODOLOGJIKE	29
4	UDHËZIME PËR VLERËSIMIN.....	32

1 HYRJE

Lënda “Gjuhë e Huaj” (anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht) synon zhvillimin gjuhësor dhe letrar i cili është boshti themelor për rritjen intelektuale, sociale dhe emocionale të nxënësit. Më konkretisht, lënda “Gjuhë e Huaj”, e aftëson nxënësin në përdorimin e gjuhës për të komunikuar, për të përmbushur interesat e tij personale dhe shoqërore, si dhe për të plotësuar kërkesat e shoqërisë dhe të botës së punës.

Mësimi i gjuhës amtare, i letërsisë dhe i gjuhëve të huaja e ndihmon nxënësin të bëhet individ i pavarur, i lirë, i kulturuar, mendimtar kritik dhe krijues, si dhe i vetëdijshëm për identitetin e tij personal dhe kombëtar. Me anë të leximit të teksteve të letërsisë shqipe dhe asaj botërore (në gjuhën shqipe ose në një gjuhë të huaj), nxënësi zhvillon botën e tij emocionale, pasuron përfytyrimet dhe imagjinatën e tij për botën, çmon dhe vlerëson gjuhët dhe kulturën kombëtare e botërore.

Fusha “Gjuhët dhe komunikimi” nxit dëshirën, kuriozitetin dhe besimin e nxënësit për t’u bërë komunikues i mirë, lexues aktiv e i pavarur dhe shkruar i saktë, origjinal dhe krijues.

Gjuha e huaj në arsimin e mesëm të ulët fillon në shkallën e dytë (klasa III) dhe mësohet deri në shkallën e katërt (klasa IX).

Kompetencat përcaktohen si njohuri, shkathtësi, vlera dhe qëndrime që nxënësi duhet t’i fitojë gjatë procesit mësimor.

Njohuri është një e vërtetë e arsyetuar dhe e provuar sipas kritereve të përcaktuara, e kodifikuar në tekstet akademike e ato shkollore apo në vepra të specializuara si produkt i një ose disa dijetarëve apo praktikienëve, ndërtim mendor i realizuar nga personi gjatë bashkëveprimit me mjedisin ose nga vetëreflektimi për t’u bërë pjesë e trashëgimisë njohëse të tij, si p.sh., njohuri për llojet e teksteve, njohuri gramatikore, njohuri për hartimin e një prezantimi etj.

Shkathtësi është një kapacitet (mendor/fizik) i fituar për të arritur rezultatet e parashikuara, shpesh me shpenzim minimal të kohës ose energjisë ose të të dyjave bashkë. Shkathtësia mund të jetë e përgjithshme ose e veçantë, si: të kuptuarit, të interpretuarit, të menduarit në mënyrë kritike dhe krijuese, zgjidhja e problemeve etj.

Qëndrimet janë një mënyrë e përcaktuar e të menduarit, opinioneve dhe ndjenjave ndaj diçkaje, një ideje, personi ose situatë dhe që ndikojnë në sjelljen e individit. Qëndrimet ndikohen nga njohuritë dhe vlerat dhe janë zakonisht shkaktoare të sjelljeve (edhe pse lidhjet mes qëndrimeve dhe sjelljeve nuk janë drejtvizore).

Vlerat janë bindje që ruhen thellë lidhur me çfarë është e rëndësishme ose e dëshirueshme. Ajo shprehet nëpërmjet qëndrimeve dhe veprimeve praktike të personave. Disa vlera dhe qëndrime janë respektimi i rregullave të etikës gjatë të folurit, shmangia e fyerjeve dhe paragjyqimeve, si dhe formave të tjera denigruese të gjuhës, shpirti i iniciativës, serioziteti, vetëbesimi etj.

Puna për ndërtimin e kompetencave kyçe dhe të lëndës fillon që në arsimin bazë.

2 KORNIZA KONCEPTUALE E PROGRAMIT LËNDOR “GJUHË E HUAJ”

Hartimi i programit lëndor mbështetet në dokumentet kryesore kurrikulare: Korniza Kurrikulare, kurrikula bërthamë për AMU-në dhe plani mësimor i arsimit për fëmijët e ngjuar.

Programi shoqërohet me udhëzues dhe dokumente të tjera në ndihmë të mësuesve dhe të hartuesve të teksteve mësimore.

Përdoruesit e programit janë mësuesit, autorët e teksteve, specialistët e arsimit dhe fakultetet e mësuesisë.

Mësuesit do ta përdorin programin e gjuhës së huaj për të krijuar një tablo të qartë rreth asaj se çfarë duhet të nxëjë nxënësi dhe se si duhet të ndërtojnë mësimdhënien për të pajisur nxënësin me kompetencat kyçe dhe të lëndës, si dhe për të përmbushur kërkesat e programit. Ky program i ndihmon mësuesit të reflektojnë mbi praktikën e tyre të mësimdhënies dhe të koordinojnë punën dhe përpjekjet e tyre për të përmbushur nevojat e nxënësit në të kuptuarin e lëndës dhe përdorimin praktik edhe jashtë ambjentëve shkollorë pasi mësuesit janë modele të cilat nxënësi ndjek në të ardhmen. Mësuesit do ta përdorin këtë program për të përcaktuar, monitoruar objektivat e vendosura për t'u përmbushur nga nxënësi në klasë, në shkollë si edhe në një raport më të gjerë.

Autorët e teksteve do ta përdorin programin lëndor për të hartuar tekste që janë në funksion të realizimit të tij. Leximi i kujdesshëm i programit për çdo shkallë dhe klasë do t'i ndihmojë për të siguruar koherencën dhe për të shmangur ngarkesën e panevojshme.

Specialistët e arsimit mund ta përdorin programin lëndor për qëllime inspektimi, monitorimi, vlerësimi, studimi etj. Vlerësuesit e sistemit arsimor do të mbështeten në këtë program për të parë përmbushjen e standardeve lëndore të përcaktuara për këtë klasë.

Fakultetet e mësuesisë mund ta përdorin programin lëndor për të përshtatur kurrikulat e tyre, me qëllim përgatitjen efektive të mësuesve të ardhshëm, si dhe për praktikën pedagogjike të studentëve.

Përfituesit e programit janë: nxënësit, prindërit dhe komuniteti.

Nxënësi përfiton të nxënit progresiv, zbaton shprehitë njohuritë, veprimtaritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat në lëndën e gjuhës së huaj dhe bëhet përdorues i mirë i gjuhës të cilën ai po mëson.

Prindërit dhe komuniteti mund të informohen për kompetencat që duhet të zotërojnë dhe të forcojnë fëmijët e tyre në lëndën e gjuhës së huaj.

Programi lëndor “Gjuhë e huaj” ka në fokus realizimin e kompetencave kyçe dhe të kompetencave të lëndës. Gjatë punës për përmbushjen e kompetencave kyçe dhe kompetencave të lëndës, nëpërmjet gjuhës së huaj do të realizohen temat ndërkurrikulare, të cilat mundësojnë lidhjen e lëndës me jetën e përditshme, shoqërinë dhe botën e punës. Në program, gjithashtu, përshkruhet lidhja e gjuhës së huaj me fushat e tjera, në mënyrë që formimi i nxënësit të mos jetë fragmentar, por tërësor dhe t’i shërbejë formimit të tij të gjithanshëm.

Realizimi i programit në lëndën e gjuhës së huaj mundëson krijimin e një mjedisi të nxëni të përshtatshëm, inkurajues, motivues, gjithëpërfshirës dhe të pasur me materiale të domosdoshme burimore duke përdorur sa më gjerë dhe në mënyrë efektive TIK-un.

Në program janë përcaktuar njohuritë, aftësitë, shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet për çdo kompetencë të lëndës si edhe për çdo veprimtari, aftësi dhe shkathtësi gjuhësore që kryen nxënësi për formimin dhe konsolidimin e kompetencave.

Gjithashtu programi mundëson mësuesin të jetë krijues dhe inovativ në punën e tij duke përdorur metodat, strategjitë dhe përjasjet më bashkëkohore në procesin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe vlerësimit. Po kështu, në program janë sugjeruar edhe orët mësimore në përqindje për njohuritë që do merren gjatë vitit shkollor.

Diagrama e mëposhtme paraqet se si programi i gjuhës së huaj është pjesë integrale e Kornizës Kurikulare e cila synon një mësimdhënie me në qendër nxënësin, zhvillimin dhe përgatitjen e tij për t’u bërë anëtar i shoqërisë së dijes.




Diagrama 1: Korniza Konceptuale e programit lëndor “Gjuhë e Huaj”

2.1 Qëllimet e programit lëndor “Gjuhë e Huaj”

Qëllimet e lëndës së gjuhës së huaj në arsimin e mesëm të ulët janë:

- zhvillimi i aftësive për të folur, dëgjuar, lexuar dhe shkruar tekste të llojeve të ndryshme letrare dhe joletrare, si dhe kultivimi nëpërmjet këtyre teksteve i mendimit kritik e krijues;
- përdorimi i gjuhës dhe mjeteve të saj në varësi të situatës dhe qëllimit që kanë nxënësit;
- gjetja, kuptimi, analiza dhe vlerësimi i informacioneve.

Programi lëndor “Gjuhë e huaj” për klasën VI-VII-VIII-IX është hartuar në përputhje me Kurrikulën Kombëtare të Gjuhëve Moderne për Arsimin Publik Parauniversitar (viti 2000), si dhe në përputhje me Kuadrin e Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët (KPER) dhe synon të arrijë dhe të realizojë standardet e mësimdhënies, mësimnxënies dhe vlerësimit me qëllim që t’i përgjigjet një shoqërie të hapur sipas kërkesave dhe nevojave që shtrohen përpara mësimin dhe përvetësimit të gjuhës së huaj në vendin tonë.

Lënda e gjuhës së huaj ka për mision aftësimin dhe orientimin e nxënësit për të vepruar në situata të ndryshme komunikimi në këtë gjuhë. Ajo ka për detyrë të zhvillojë te nxënësi aftësitë e gjuhës gjatë përdorimit të saj dhe t’a edukojë atë me të kuptuarin, pranimin dhe vlerësimin e kulturës dhe mënyrës së jetesës së popujve të tjerë. Programi hartohet mbi interesat dhe karakteristikat e grupmoshës dhe ndihmon në zhvillimin intelektual dhe socio-kulturor të nxënësit duke e bërë atë të pavarur dhe të aftë të përballojë të nxënit gjatë gjithë jetës. Nxënësi, gjithashtu, mëson dhe bindet se gjuha e huaj, si një subjekt aftësish dhe komunikimi, kërkon kohë dhe praktika të shumëllojshme komunikimi për t’u përvetësuar. Si lëndë akademike, gjuha e huaj është një lëndë kulturash dhe aftësish.

Mësimi i gjuhës së huaj fillon në klasën e tretë të arsimit fillor. Referuar Kuadrin të Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët nxënësi në fund të klasës së nëntë synon të arrijë nivelin A1 duke marrë edhe disa elemente të nivelit A2. Tashmë nxënësi i familjarizuar me gjuhën e përdor atë në situata komunikimi dhe aktivitete të thjeshta.

Më poshtë jepet përshkrimi i nivelit A1

Shkalla Globale	Mund të kuptojë dhe të përdorë shprehje të përditshme dhe shprehje bazë që synojnë plotësimin e nevojave konkrete.
A 1	Mund të prezantojë veten dhe të tjerët dhe të pyesë e të përgjigjet për detaje vetjake si: ku jeton, banon, njerëzit që njeh, sendet që ka etj. Mund të komunikojë në një mënyrë të thjeshtë nëse bashkëbiseduesi flet ngadalë, qartë dhe është i gatshëm të ndihmojë.

Në këtë nivel nxënësi identifikohet si përdorues fillestar i gjuhës. Meqënëse nxënësi e mëson gjuhën e huaj në një mjedis ku nuk flitet kjo gjuhë ai e përmbush nivelin A1 në fund të klasës së nëntë dhe merr elemente të nivelit A2.

Ky program synon që nxënësi të mund të përvetësojë shkallë-shkallë njohuri gjuhësore e social-kulturore, duke siguruar përveç mësimin të gjuhës edhe qëndrime, sjellje dhe vlera të caktuara që inkurajojnë zhvillimin e individualitetit të tij.

Nxënësi tashmë i ka hedhur hapat e parë në zbulimin e gjuhës së huaj. Nëpërmjet situatave të larmishme dhe tërheqëse për moshën, realizohet zhvillimi i gjithanshëm i nxënësit në aspektin njohës, gjuhësor, emocional dhe kulturor. Mësuesi punon dhe mundëson që nxënësi tashmë i familjarizuar me muzikalitetin e gjuhës dhe me një fjalor bazë rreth jetës së tij personale të zhvillojë më tej aftësitë psikomotore, gjuhësore dhe socio-gjuhësore në përputhje me grupmoshën e nxënësve dhe përmbushjen e kompetencave kyçe dhe lëndore për këtë grupmoshë duke filluar të komunikojë thjeshtë me fjali dhe dialogje të shkurtra.

Nxënësi riprodhon dhe tenton të krijojë elementë të thjeshtë të gjuhës së huaj me një strukturë të kufizuar gramatikore (kryefjalë dhe kundrinor) që i përkasin një repertori të memorizuar për informacion mbi veten dhe nevojat e përditshme.

2.2 Lidhja e kompetencave kyçe me kompetencat e lëndës “Gjuhë e Huaj”

Realizimi i kompetencave kyçe të Kornizës Kurrikulare gjatë procesit të mësimdhënies dhe nxënies kërkon që mësuesi të lidhë kompetencat kyçe me kompetencat e fushës dhe ato specifike të lëndës për secilën shkallë. Për të realizuar në praktikë këtë lidhje, mësuesi duhet të përzgjedhë metodat, teknikat dhe mjetet e përshtatshme didaktike për realizimin e çdo kompetence dhe rezultati të të nxënit. ***Kompetenca përcaktohet si harmonizim i njohurive, shkathtësive, vlerave dhe qëndrimeve për të trajtuar plotësisht situatat e kontekstit.*** Kur nxënësi përmbush kompetencat gjuhësore, ai njëkohësisht është duke zhvilluar edhe kompetencat kyçe. P.sh., gjatë prezantimeve të ndryshme në orët mësimore të kompetencës së të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar, nxënësi përdor edhe mjetet e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit dhe realizon kështu edhe kompetencën digjitale. Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës ku bën pjesë lënda e gjuhës së huaj, pasqyrojnë të njëjtën qasje me rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe në këndvështrimin e domosdoshmërisë së tyre në jetë, shoqëri dhe punë.

Përqasja e adoptuar nga Kuadri i Përbashkët Evropian i Referencave për Gjuhët (KPER) është e orientuar drejt veprimit pasi përdoruesit e gjuhës ose nxënësit konsiderohen si “aktorë shoqërorë” d.m.th. pjesëtarë të shoqërisë të cilët kanë detyra për të përmbushur (të cilat nuk janë vetëm gjuhësore) në rrethana dhe në një mjedis të caktuar dhe brenda një fushe të caktuar veprimi. Komunikimi realizohet nëpërmjet veprimtarive gjuhësore të cilat janë pjesë e një konteksti më të gjerë shoqëror që ju jep atyre kuptim të plotë. Përqasja vepruese merr gjithashtu parasysh burimet njohëse, emocionale, të vullnetshme si edhe tërësinë e aftësive që zotëron dhe vë në jetë çdo individ si një aktor shoqëror.

Në bazë të kësaj përqasjeje çdo formë përdorimi dhe nxënieje e një gjuhe mund të përkufizohet si më poshtë.

Përdorimi i një gjuhe, duke përfshirë edhe nxënien e saj, përfshin veprime të kryera nga njerëzit, të cilët si individë dhe si aktorë shoqërorë, zhvillojnë një numër **kompetencash kyçe** dhe në veçanti **kompetencat e komunikimit gjuhësor**. Ata vënë në zbatim kompetencat që zotërojnë në kontekste dhe kushte të ndryshme dhe kalojnë vështirësitë për t'u përfshirë në veprimtari gjuhësore të cilat përfshijnë proceset gjuhësore që mundësojnë kuptimin dhe prodhimin e teksteve që lidhen me tema dhe fusha specifike duke mobilizuar strategjitë më të përshtatshme për

përmbushjen e detyrave që duhen realizuar. Monitorimi i këtyre veprimeve nga vetë pjesëmarrësit çon në përforcimin ose përmirësimin e kompetencave.

Kompetencat kyçe nuk lidhen vetëm me gjuhën por kanë të bëjnë me çdo lloj veprimtarie duke përfshirë edhe ato gjuhësore.

Më konkretisht, për të realizuar lidhjen e kompetencave kyçe me kompetencat e fushës mësuesi ndjek këto hapa:

- përzgjedh rezultatin/et e të nxënit për kompetencat kyçe që synon të arrijë nxënësi në shkallën dhe klasën përkatëse;
- përzgjedh rezultatin/et e të nxënit për kompetencat specifike të fushës që synon të arrijë nxënësi në shkallën dhe klasën përkatëse;
- duke u bazuar tek kompetencat e përgjithshme dhe ato të komunikimit gjuhësor mësuesi përshtat rezultatin/et e të nxënit për çdo fushë aktiviteti të gjuhës, (me shkrim dhe me gojë): marrja e informacionit (të lexuarit, të dëgjuarit), ndërveprimi (të folurit ndërveprues, të shkruarit ndërveprues), produkti (produkti i të folurit, produkti i të shkruarit) dhe ndërhyrja (përmbledhja, interpretimi, perifrazimi, përkthimi etj).
- përzgjedh përmbajtjen/et mësimore, mjetet didaktike, metodologjinë e mësimdhënies, përmes të cilave realizon rezultatet e të nxënit;
- planifikon mësimdhënien duke përfshirë periudhën kohore gjatë së cilës do t'i arrijë rezultatet e të nxënit brenda vitit shkollor;
- kryen analiza dhe vlerësime të ecurisë së nxënësve pas realizimit të orëve mësimore, detyrave, projekteve, për të verifikuar arritjet e rezultateve të të nxënit për vit mësimor dhe shkallë për fushën “Gjuhët dhe komunikimi”.

Diagrama e mëposhtme konkretizon lidhjen e kompetencave kyçe me kompetencat specifike të lëndës të cilat së bashku i ofrojnë nxënësit informacionin në mënyrë efektive dhe bëjnë që nxënësi të përforcojë hap pas hapi arritjet e tij për të lexuar, shkruar dhe komunikuar duke i bërë funksionale dhe të qëndrueshme aspekte të ndryshme të informacionit, kulturës, shkencës dhe teknologjisë.




Diagrama 2: Lidhja e kompetencave kyçe me ato të lëndës “Gjuhë e Huaj”

2.3 Rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës “Gjuhë e Huaj”

Në kurrikulën bërthamë janë përcaktuar rezultatet e të nxënit për kompetencat kyçe. Këto rezultate përmbushen nëpërmjet fushave të të nxënit. Natyrisht, secila fushë dhe lëndë mund të kontribuojë në disa rezultate të nxëni. Fusha “Gjuhët dhe komunikimi” ndihmon realizimin e të gjitha kompetencave, por më së shumti në kompetencën e komunikimit dhe të shprehurit. Tabela e mëposhtme paraqet rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së gjuhës së huaj në klasën VI, VII, VIII, IX.

Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit

Nxënësi:

- | |
|--|
| <ul style="list-style-type: none">• shpreh me gojë dhe me shkrim fjali të thjeshta në gjuhën e huaj dhe i përkthen në gjuhën amtare;• merr pjesë në bashkëbisedime me moshatarët dhe të rriturit për tema me interes mësimor dhe shoqëror duke bërë pyetje, duke dhënë përgjigje me fjali të thjeshta;• transmeton saktë të dhënat e mbledhura për një temë konkrete në formë tekstuale, numerike, verbale, elektronike apo në ndonjë formë tjetër të të shprehurit;• prezanton para të tjerëve një projekt për një temë të dhënë, të përgatitur vetë ose në grup, duke gërshetuar format e komunikimit verbal dhe elektronik, si dhe veprimin praktik;• përshkruan me gojë dhe me shkrim duke përdorur fjali të thjeshta një ngjarje të lexuar ose të dëgjuar duke ruajtur rrjedhën logjike të saj;• harton një tekst të shkurtër dhe të thjeshtë duke vazhduar një rrëfim gojor apo tekst të lexuar më parë;• identifikon burime të ndryshme informacioni. |
|--|

Kompetenca e të menduarit

Nxënësi:

- përzgjedh dhe klasifikon informacionin nga burime të ndryshme në bazë të një kriteri të caktuar për një temë konkrete dhe të njohur për të;
- analizon një punim, pikturë, foto etj. duke gjetur analogji dhe dallime me punime të ngjashme nga autorë të ndryshëm;
- përpunon idenë e vet në një projekt me shkrim për një çështje të caktuar duke propozuar qëllimin, aktivitetet kryesore, afatet, vendin, personat, materialet dhe mjetet e nevojshme për kryerjen e tyre;
- argumenton ndërmarrjen e hapave konkretë, të cilët çojnë në përfundimin e një detyre/aktiviteti, zgjidhjen e një problemi, të ndonjë punimi në klasë/shkollë , supermarket, etj.

Kompetenca e të nxënit

Nxënësi:

- regjistron në formë të shkruar, grafike, etj., informacionin/ faktet për një temë; veçon me anë të teknikave të ndryshme pjesët sipas rëndësisë dhe nevojës për temën/detyrën e dhënë;
- shfrytëzon në mënyrë efikase fjalorët dhe teknologjinë informative apo burime të tjera për zhvillimin e një ideje /projekti me bazë klase/shkolle ose jashtë saj;
- regjistron, skedon dhe përdor teknika të tjera për të m e n a x h u a r informacionin/faktet ose formulat për një temë duke i radhitur ato sipas llojit, burimit dhe rëndësisë;
- paraqet/skicon idetë e veta për ecurinë dhe mënyrën e zhvillimit të një aktiviteti duke e argumentuar para të tjerëve;
- prezanton në mënyrë të pavarur udhëzimet /simbolet e dhëna në libër, skicë, plan, partiturë muzikore, skenar, koreografi etj., për të përmbushur një veprim, aktivitet ose detyrë që kërkohet prej tij;
- shfrytëzon në mënyrë të efektshme teknika të ndryshme gjatë të nxënit të temës së dhënë duke klasifikuar informacionin e njohur nga ai i panjohur, si dhe atë që është i paqartë.

Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin

<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • vlerëson rëndësinë e punës individuale dhe në grup për zhvillimin e komunitetit nëpërmjet shembujve konkretë nga jeta e përditshme; • përdor materiale, burime të ndryshme informimi dhe teknologjinë në shkollë dhe në jetën e përditshme si ndihmë për përparimin në mësim dhe për orientim në karrierë; • përgatit një plan pune për kryerjen e një detyre ose projekti; • vlerëson dhe kritikon mënyrën e sjelljes së nxënësve në klasë, në shkollë dhe mjedise të tjera në një situatë të caktuar.
<p>Kompetenca personale</p>
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • kupton dhe shpreh idetë dhe mendimet e veta mbi fushat e tij të interesit; • analizon shkaqet e një reagimi konfliktual apo emocional; • propozon alternativa për zgjidhje të drejtë e pa pasoja duke ndarë përvojat, mendimet dhe ndjenjat me anëtarët e grupit.
<p>Kompetenca qytetare</p>
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • praktikon të drejtat dhe detyrimet si qytetar në situata konkrete të jetës së përditshme, në klasë, shkollë, komunitet ose gjatë diskutimit dhe respektimit të mendimit të tjetrit; • reagon ndaj personave të cilët shkelin, cënojnë ose mohojnë të drejtat e të tjerëve si dhe arsyeton pasojat e këtyre veprimeve për individin, grupin dhe komunitetin; • përgatit në grup një aktivitet, duke përdor tolerancën si mjet për promovimin e diversitetit kulturor, etnik, gjinor, fetar, social etj., në shkollë apo në komunitet.
<p>Kompetenca digjitale</p>

Nxënësi:

- përdor TIK-un për të lehtësuar procesin e të nxënës dhe për të rritur efektivitetin në mësimnxënie.
- përdor mjetet multimediale për të bashkëpunuar me persona të tjerë dhe për të rritur produktivitetin e tij dhe të nxënës efektiv.
- bashkëpunon me moshatarët e tij duke përdorur mjetet e telekomunikacionit bashkëpunues, për të trajtuar tema mësimore, për të zgjidhur çështje dhe probleme që mund të lindin në shkollë dhe jashtë saj.

2.4 Lidhja e lëndës “Gjuhë e Huaj” me temat ndërkurrikulare

Temat ndërkurrikulare janë tema madhore, me të cilat përballet shoqëria tani dhe në të ardhmen. Ato integrojnë fushat e të nxënës, të cilat ndihmojnë nxënësit të interpretojnë botën dhe të lidhin dijet e marra në shkollë me jetën dhe interesat e tyre. Në Kornizën kurrikulare dhe në kurrikulat bërthamë janë përcaktuar temat ndërkurrikulare, të cilat janë:

- Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave.
- Të drejtat e njeriut.
- Vendimmarrja morale.
- Zhvillimi i qëndrueshëm.
- Mjedisi.
- Ndërvarësia.
- Bashkëjetesa paqësore.

Gjuha e huaj zhvillon te nxënësit njohjen e vlerësimin e kulturës dhe traditës botërore dhe kultivon identitetin dhe krenarinë kombëtare. Tema si: të drejtat e njeriut, vendimmarrja morale, mjedisi, zhvillimi i qëndrueshëm etj. mund të realizohen gjatë orëve mësimore të kompetencës së të

folurit. Mësuesi mund të krijojë edhe situata mësimore gjatë të cilave nxënësit shprehen në forma të ndryshme: ese, poezi, tregime dhe krijime të tjera me tematikë çështjet e mësipërme.

Punët në grupe dhe projektet që zhvillohen në lëndën e gjuhës së huaj, ndihmojnë në krijimin e aftësive të nxënësve për të jetuar në mënyrë paqësore me të tjerët, me natyrën dhe për të promovuar detyrat dhe të drejtat e individit në një shoqëri të lirë dhe demokratike.

2.5 Lidhja e lëndës “Gjuhë e Huaj” me fushat e tjera kurrikulare

Programi lëndor “Gjuhë e huaj” mbështetet në integrimin ndërlëndor. Gjuha e huaj e pajis nxënësin me njohuri, aftësi dhe shkathtësitë që sigurojnë suksesin e tij edhe në fushat dhe lëndët e tjera. Kompetencat gjuhësore janë kompetenca që ndihojnë nxënësin në procesin e të nxënit në të gjitha fushat kurrikulare. Konceptet e njohuritë gjuhësore trajtohen e mësohen më mirë në kontekste të caktuara kuptimore dhe ligjërimore, të cilat lidhen ngushtë me fusha tematike të parashtruara në programin e gjuhës së huaj dhe të trajtuara në lëndët e tjera.

Nxënësi zgjeron fjalorin dhe zhvillon aftësinë e të shprehurit qartë me shkrim dhe me gojë në fushat e tjera.

Gjuha e huaj mundëson nxënësin që të kuptojë dhe analizojë tekste ose mesazhe të ndryshme. Duke lexuar tekste të fushave të ndryshme (gjeografi, qytetari etj.) nxënësi zgjeron njohuritë për atë fushë. Leximi dhe analiza e teksteve letrare ndikon në të kuptuarin e ngjarjeve dhe figurave historike, marrdhënieve historike dhe vlerave shoqërore. Me fushën shoqëria dhe mjedisi janë të lidhura tema si: miqësia, marrdhëniet familjare, marrdhëniet në shkollë, koha e lirë, festat etj.

Duke përvetësuar aktet dhe funksionet gjuhësore nxënësi mëson si të komunikojnë me të tjerët në mënyrë korrekte dhe gramatikusht të saktë.

Gjithashtu përvetësimi i mirë i gjuhës së huaj ndihmon nxënësin të zhvillojë më tej punën e tij kërkimore në fushat e tij të interesit (histori, shkenca, matematikë etj.) pasi shumë materiale gjenden në gjuhë të huaj. Integrimi i lëndëve të tjera në gjuhën e huaj ndihmon jo vetëm në lidhjen ndërlëndore, por edhe në pasurimin e një leksiku më specifik dhe përdorimin e tij. Lidhja me *shkencat natyrore* p.sh. me matematikës dhe gjuhës së huaj shprehet në mësimin numrave, veprimeve matematikore (mbledhja e zbritja, shumëzimi dhe pjesëtimi).

Në lëndën e biologjisë, lidhja bëhet e qartë duke trajtuar tema, si: pjesët e trupit, ushqyerja, shëndeti, mjedisi.

Me artet janë të lidhura ngushtë temat mbi sportin, muzikën, modën, pikturën etj.

Lidhja me lëndën e TIK-ut, përmes së cilës nxënësi aftësohet të përdorë internetin, e-mail-in, programe të ndryshme, platforma digjitale, aplikacione etj, ndihmon atë të eksplorojë të rejtat mbi botën që po studion, të prezantojë sa më bukur dhe në mënyrë logjike idetë dhe opinionet e tij dhe të marrë informacionin në kohë reale.

Në këtë klasë nxënësi hedh hapat e parë drejt të mësuarit ndërlëndor dhe mënyrave të lidhjes së lëndës së gjuhës së huaj me lëndët e fushave të tjera. Mësuesi punon që nxënësi gjatë gjithë procesit të të mësuarit të gjuhës së huaj të përdorë edhe njohuritë, shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet e marra në fushat e tjera të dijes.

Më konkretisht, kjo lidhje jepet në diagramën e mëposhtme.




Diagrama 3: Lidhja e lëndës “Gjuhë e Huaj” me fushat e tjera kurrikulare

2.6 Kompetencat e lëndës “Gjuhë e Huaj”

Lënda “Gjuhë e Huaj” synon forcimin e kompetencës kyçe të komunikimit dhe të shprehurit për këtë qëllim zhvillon kompetencat e saj të cilat trajtohen më poshtë.

Kompetenca e komunikimit gjuhësor e fuqizon një person të veprojë duke përdorur specifikisht mjetet dhe mënyrat gjuhësore. Për të realizuar qëllimet komunikuese, nxënësi mobilizon të gjitha kapacitetet e tij dhe i kombinon ato me kompetencën e komunikimit gjuhësor. Kompetenca e komunikimit gjuhësor është një sintezë e njohurive të parimeve bazë gramatikore, e njohurive se si gjuha përdoret në ambiente shoqërore për të kryer funksionin komunikues dhe e njohurive se si funksionet komunikuese kombinohen me parimet e ligjërimit.

Përshkrimi i kompetencave të lëndës “Gjuhë e Huaj”

Kompetenca e komunikimit gjuhësor përbëhet nga kompetencat e mëposhtme të lëndës:

Kompetenca gjuhësore nënkupton përvetësimin e rregullave gramatikore, semantike, fonetike, ortografike si dhe pasurimin e fjalorit.

Kompetenca socio-gjuhësore ka të bëjë me dimensionin shoqëror të gjuhës dhe i referohet të mësuarit të akteve të ndryshme të ligjërimit dhe komunikimit në kontekste të ndryshme shoqërore. Këto kontekste kanë të bëjnë me statusin shoqëror, gjininë, moshën e nxënësit si dhe me faktorë të tjerë që influencojnë në stilin dhe regjistrat e gjuhës. Zhvillimi i kësaj kompetence është shumë i rëndësishëm pasi në situata të ndryshme duhen përdorur lloje të ndryshme shprehjesh si edhe duhen mbajtur qëndrime, besime, vlera dhe pikëpamje të ndryshme.

Kompetenca pragmatike ka të bëjë me njohjen e rregullave dhe parimeve sipas të cilave mesazhi komunikues organizohet dhe strukturohet (zhvillimi i temës, lidhja logjike e ideve, koherenca e mendimeve) dhe realizimin e funksioneve komunikuese (kërkimi i informacionit, dhënia e këshillës, kërkimi për ndihmë, rrënia dakort, përshendetjet etj).

Dy faktorë cilësorë të cilët përcaktojnë suksesin e nxënësit në realizimin e funksioneve komunikuese janë:

- a. Rrjedhshmëria
- b. Saktësia e të shprehurit

Duke u bazuar tek kompetencat kyçe dhe ato të komunikimit gjuhësor, nxënësi përdor aftësi dhe strategji të përshtatshme për përmbushjen e detyrave në veprimtaritë gjuhësore (me shkrim dhe me gojë): **marrja e informacionit** (të lexuarit, të dëgjuarit), **ndërveprimi** (të folurit ndërveprues, të shkruarit ndërveprues), **produkti** (produkti i të folurit, produkti i të shkruarit) dhe **ndërhyrja** (përmbledhja, interpretimi, perifrazimi, përkthimi etj). Kryerja e vazhdueshme e veprimtarive gjuhësore bën që nxënësi të forcojë aftësitë dhe shkathtësitë **e të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit.**

Lidhja midis aftësive, shkathtësive, veprimtarive dhe kompetencave mund të shihet si një lidhje burimore ku nxënësi gjen tek kompetencat mjetet për të realizuar aktivitetet, por këto të fundit modifikohen dhe shtohen gjatë procesit të komunikimit. Një numër i kufizuar kompetencash i lejon nxënësit të kryejë një numër shumë të madh veprimtarish. Të kuptuarit e këtij dallimi është thelbësor për të bërë të suksesshëm procesin e të mësuarit dhe të nxënimit të gjuhëve.

Përdorimi i gjuhës veçanërisht në ndërveprim me të tjerët lejon përvetësimin e gjuhës, e cila në vetvetë përfshin zhvillimin e kompetencave. Të mësuarit e pakontekstualizuar të kompetencave (si p.sh. mësimi i rregullave gramatikore) e ndihmon nxënësin, por nuk është i mjaftueshëm për të përdorur gjuhën si një mjet komunikimi.




Diagrama 4: Lidhja e kompetencave të lëndës “Gjuhë e Huaj” me veprimtaritë, aftësitë dhe shkathtësitë gjuhësore

2.7 Rezultatet e të nxënit

Më poshtë jepen rezultatet e të nxënit në fund të nivelit A 1 i cili përmbillet në fund të klasës së nëntë. Duke iu referuar tabelës, kuptohet qartë se nxënësi nuk mund t'i përmbushë të gjithë elementët e kompetencave të lëndës brenda një viti ose edhe disa viteve. Mësuesi punon sistematikisht që këto rezultate të përmbushen gjatë gjithë viteve të shkollës.

KOMPETENCAT E LËNDËS		REZULTATET
1. GJUHËSORE Nxënësi zotëron një fjalor shumë bazë që ka të bëjë me detajet personale dhe nevojat e tij konkrete.	a. Fjalori	Zotëron fjalor bazë me fjalë të shkëputura dhe shprehje që lidhen me situatë shumë konkrete.
	b. Saktësia gramatikore	Tregon kontroll të kufizuar mbi struktura shumë të thjeshta gramatikore dhe modele fjalish të mësuara paraprakisht.
	c. Fonetika	Shqipton mirë një repertor të kufizuar fjalësh dhe shprehjesh dhe disa herë nuk mund të kuptohen nga një folës vendas i gjuhës.
	d. Ortografia	Kopjon fjalë dhe shprehje të shkurtra të njohura për të si p.sh. emrat e sendeve, udhëzime, emrat e dyqaneve etj. Gërmëzon adresën e tij, kombësinë dhe detaje të tjera personale.
2. SOCIO-GJUHËSORE	a. Aktet e ligjërimit dhe komunikimit	Vendos kontakte shoqërore shumë të thjeshta duke përdorur përsëritjet dhe shprehjet e përditshme të mirësjelljes si p.sh. të lutem, faleminderit, më vjen keq, mirupafshim etj.
3. PRAGMATIKE	a. Fleksibiliteti	Nuk ka rezultat përshkrues në këtë nivel
	b. Pjesëmarrja në bashkëbisedim	Nuk ka rezultat përshkrues në këtë nivel

	c. Zhvillimi i temës	Nuk ka rezultat përshkrues në këtë nivel
	d. Koherenca	Lidh fjalët në grupe fjalësh me lidhësat bashkërenditëse “dhe”, “pastaj”

Aspektet cilësore të përdorimit të gjuhës së folur për nivelin A 1

	Gama/diapazoni	Saktësia	rrjedhshmëria	ndërveprimi	Koherenca/ lidhja logjike
A 1	Ka një repertor fjalësh dhe shprehjesh të thjeshta bazë që lidhen me detajet personale dhe me situatë shumë konkrete.	Tregon një kontroll të kufizuar të disa strukturave të thjeshta gramatikore dhe modele fjalish të një repertori të mësuar përmendsh.	Mund të përdorë fjali shumë të shkurtra, të izoluara dhe të parapërgatitura duke bërë shumë ndalesa për të gjetur fjalën ose shprehjen, për të shqiptuar fjalët më pak të njohura kur merr pjesë në bashkëbisedim.	Mund të bëjë pyetje dhe t`iu përgjigjet pyetjeve për detaje personale. Mund të bashkëveprojë në mënyrë shumë të thjeshtë por bashkëbisedimi varet komplet mbi përsëritjen dhe riformulimin e asaj që është thënë.	Mund të lidhë fjalë ose grupe fjalësh me lidhëzat bazë si “ dhe” ose “pastaj”.

Për përmbushjen e kompetencave të lëndës të cilat çojnë natyrshëm në forcimin e kompetencave të fushës dhe atyre kyçe, nxënësit i duhet të konsolidojë njohuritë dhe konceptet e duhura, të aftësohet në shkathhtësitë e fituara dhe të mbajë qëndrime në situata të ndryshme.

Njohuri dhe koncepte që nxënësi do të marrë në përfundim të klasës IX:

1. Formimi kulturor:

- a. **Jeta e përditshme** (*veshja, lodrat, objektet që na rrethojnë, ngjyrat, ushqimet, frutat, perimet, ditët e javës, muajt e vitit, etj.*)
- b. **Jeta shkollore** (*klasa, shokët e mi, numërorët, objektet që na rrethojnë në shkollë, lëndët shkollore, shkolla, orari*)
- c. **Jeta personale dhe shoqërore** (*familja, antarët e familjes, komuniteti, shtëpia, festat, pushimet, aktivitetet në kohën e lirë*)
- d. **Bota rreth nesh** (*qytetet, shtetet, natyra, flora fauna, mjetet e transportit, tabela dhe shenja rrugore etj*)
- e. **Bota e komunikimit** (*kartolina, ditëlindje, ftesa, mesazhe të shkurtra të thjeshta, festa kombëtare*)

2. Formimi gjuhësor:

- a. **Gramatika** (*emrat në numrin njëjës dhe shumës, gjymtyrët e fjalisë, kohët e thjeshta të foljes, mbiemrat, nyjet, mënyra urdhërore, lidhëza, përemrat etj*)
- a. **Funksionet gjuhësore** (*përshëndetjet, dëshirat, mundësitë, urdhrat*)

Aftësi dhe shkathtësi:

Të dëgjuarit

Përshkrimi:

Nxënësi ndjek një bisedë e cila zhvillohet shumë ngadalë dhe shqiptohet qartë dhe me pauza të gjata duke marrë mesazhin e duhur që përcillet. Ai dëgjon dhe kupton fjalë dhe fjali të shkurtra nga jeta e përditshme nëse flitet qartë dhe ngadalë.

Nxënësi:

- dëgjon dhe reagon me veprime ndaj orientimeve, udhëzimeve të mësuesit ose bashkëfolësit;
- dëgjon dhe reagon ndaj fjalive të thjeshta, të artikuluar ngadalë dhe me gjuhë të qartë;
- identifikon objekte të ndryshme, kur ato përmenden apo tregohen në tregime të shkurtra ose reklama të thjeshta;
- identifikon udhëzime të thjeshta në klasë dhe jashtë saj;
- dëgjon dhe reagon ndaj përshëndetjeve dhe urdhrave;
- identifikon objekte të ndryshme, kur i kërkohet të përgjigjet rreth tyre;
- kupton mesazhin e transmetuar me fjalë dhe shprehje të thjeshta në lidhje me informacionin personal apo nevoja klase apo rrethana gjuhësore jashtë saj;
- ndjek orientime të shkurtra dhe të thjeshta;
- kupton në nivel të kënaqshëm shprehje të përdorimit të gjerë për të realizuar nevojat të thjeshta si kërkim leje, ndjese etj. kur ato përcillen thjesht dhe qartë, ngadalë dhe me përsëritje nëse është e nevojshme.

Të lexuarit

Përshkrimi:

Nxënësi kupton emra të njohur, fjalë dhe fraza të thjeshta. Lexon fjalë dhe fjali të thjeshta. Ai përdor strategji për të kuptuar tekstin si: lidh figurën me fjalën, grupon fjalë sipas grupeve kuptimore.

Nxënësi:

Të lexuarit fillestar

- dallon dhe lexon fjalë dhe fraza të njohura, të mësuara më parë;
- hamendëson kuptimin e fjalëve apo frazave në bazë të pikturave;
- lexon tekste të shkurtra që përmbajnë fjalë dhe fraza me fjalor të njohur nga fondi bazë i gjuhës së huaj;
- rilexon tekstin për të kuptuar më mirë atë (kur është e nevojshme);
- dallon të dhëna personale në një pyetësor të thjeshtë;
- identifikon mesazhe, komente shumë të thjeshta mbi detyrat dhe punën e bërë;
- dallon vitin, muajt, ditët, në një kartolinë, frazat hyrëse, urimin dhe dërguesin e kartolinës etj;
- ndjek udhëzime të thjeshta të shkruara si p.sh. lexo tekstin, shkruaj në fletore etj;
- ndjek orientime të thjeshta dhe të shkurtra (të shkojë nga njëri vend tek tjetri);
- dallon fjalë të njohura me karakter ndërkombëtar apo të ngjashme me gjuhët e tjera, tabela orientuese apo shënime të tjera në situata të zakonshme në klasë apo jashtë saj.

Të folurit

Të folurit ndërveprues:

Përshkrimi:

Nxënësi shqipton saktë dhe me intonacionin e duhur fjalët. Ai shoqëron të folurin edhe me elemente joverbale Merr pjesë në biseda të shkurtra por bashkëfolësit i duhet të përsërisë ose perifrazojë informacionin. Kërkon dhe përcjell informacion, duke pyetur dhe duke iu përgjigjur pyetjeve për emrin moshën, ngjyrat, pjesëtarët e familjes etj.

Nxënësi:

- bën pyetje të thjeshta për atë çfarë sheh ose dëgjon duke shprehur dëshirat, ndjenjat dhe parapëlqimet;
- ndërvepron në dialogë të shkurtër, mesazhe të thjeshta, shprehje dhe tekste të thjeshta të shprehura qartë dhe ngadalë;
- pyet dhe kërkon sende që i nevojiten për të kryer një detyrë;
- pyet dhe u përgjigjet pyetjeve të thjeshta për veten, familjen, shkollën dhe vendbanimin;
- ndjek udhëzimet kur ato jepen me një gjuhë shumë të qartë;
- pyet bashkëfolësin për shëndetin, moshën, vendlindjen;
- bën një prezantim të thjeshtë rreth vetes dhe përsëritet apo përdor shprehje të mirsjelljes gjatë bashkëbisedimit;
- përdor shprehje të thjeshta për t'iu përgjigjur pyetjeve direkte të bashkëfolësit kur ato përcillen ngadalë dhe qartë me disa përsëritje nëse është e nevojshme;
- inicion një bisedë të thjeshtë rreth nevojave dhe interesave të rastit dhe i përgjigjet bashkëfolësit me shprehje të dhe fjalë të thjeshta;
- pyet dhe i përgjigjet bashkëfolësit rreth vetes dhe njerëzve që e rrethojnë për informacion thelbësor si vendbanimi, familjarët, gjuha, sendet që zotërojnë etj;
- tregon kohën duke përdorur shprehje dhe fjalë të tilla si: javën e ardhshme, të premten e kaluar, muajin nëntor, ora tre etj;

- vë në përdorim të nevojave të tij numrat, shprehjet sasiore, kohën, çmimet;
- bashkëbisedon në mënyrë të thjeshtë, por ndërveprimi varet plotësisht nga përsëritjet e bëra me një ritëm të ngadaltë, me ndihmën e perifrazimeve apo korigjimeve në shprehje apo fjalë të caktuara.

Produkti i të folurit:

Përshkrimi:

Nxënësi shprehet me fjalë dhe fjali shumë të shkurtra rreth vendeve dhe njerëzve që njeh.

Nxënësi:

- shqipton fjalë ose fraza të thjeshta me mbështetje të mësuesit;
- prezanton veten duke përdorur fjali të thjeshta;
- thotë emrin, moshën dhe vendbanimin;
- flet thjesht për njerëzit e njohur dhe familjen;
- shprehet me një fjalor të kufizuar fjalësh dhe shprehjesh të mësuara shpesh me shqiptim jo të saktë dhe më nevojën për përsëritje apo korigjim;
- shprehet me fjali të thjeshta për arsye të strukturave të kufizuara gramatikore të mësuara;
- shprehet me fjalor të thjeshtë për situatë konkrete;
- sinjalizon që ai po ndjek bisedën dhe kërkon vemendje.

Të shkruarit

Përshkrimi:

Nxënësi shkruan fjalë dhe fjali të thjeshta, një kartolinë të shkurtër përshëndetjeje, etj. Mund të sjellë detaje personale në një pyetësor, shkruan emrin, mbiemrin, kombësinë, adresën. Shkruan fjali të thjeshta dhe të shkurtra mbi tematika të njohura.

- dallon dhe zgjedh fjalë të përshtatshme për të plotësuar vende bosh në fjali apo fjalë të renditura në formë liste;
- etiketon objekte rrethore;
- formulon një kartolinë të thjeshtë urimi, duke përdorur fjalë ose fraza të shkurtra dhe standarde;
- plotëson vende bosh me fjalë duke iu referuar figurave apo pikturave të njohura;
- emërton një etiketë për një send të njohur;
- përshkruan shokë, miq, të afërm, personazhe, objekte, sende e kafshë të dashura për të me fjalë dhe fjali të shkurtra dhe të shkëputura;
- shkruan tekste të shkurtra si: një urim, një kartolinë;
- shkruan mesazhe apo tekste të shkurtëra dhe të thjeshta duke përdorur lidhëzat dhe, pastaj, por, sepse;
- përdor në mesazhe shprehje të mirësjelljes dhe shoqërizimit, për nevoja të përditshme si falenderime, lutje, ndjesë, përshëndetje etj;
- mund të kopjojë fjalë e shprehje të thjeshta si shenja orientuese, udhëzime, emra objektësh, dyqanesh apo shërbimesh;
- kopjon tekste të shkurtëra në format printimi apo shkrim dore;
- shkruan numra, data, emrin, kombësinë, adresën, datëlindjen, apo vendlindjen, vendmbëritjen në një formular të regjistrimit në hotel;
- shkruan dhe kërkon me shkrim detaje personale

Vlera dhe qëndrime

Nxënësi:

- shfaq sjellje të përshtatshme gjatë të dëgjuarit si p.sh: ndjek me vëmendje tekstin që dëgjon;
- është korrekt në komunikim dhe nuk e ndërpret bashkëfolësin kur është duke folur;
- shpreh pëlqim dhe interes, keqardhje ndaj asaj që dëgjon, duke reaguar me veprime;
- respekton mendimin e bashkëbiseduesit duke e dëgjuar me vëmendje;
- respekton rregullat e etikës gjatë komunikimit personal dhe në grup;
- respekton bashkëfolësit pa dallime gjinie, besimi, ideje;
- respekton bashkëfolësin, audiencën me fjalë dhe qëndrime;
- respekton dhe pranon mendimin ndryshe gjatë diskutimeve;
- respekton përpjekjet personale dhe ato në grup;
- demonstroi bashkëpunim dhe qëndrim etik gjatë punës në grup dhe në diskutime;
- demonstroi besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve;
- vlerëson burime të ndryshme informacioni;
- kujdeset për veten, të tjerët dhe ambientin;
- vlerëson kontributin e të tjerëve gjatë kryerjes së një detyre;
- tregon vetëbesim dhe vetëvlerësim gjatë kryerjes së detyrave të ndryshme;
- demonstroi tolerancë dhe respekt për kulturën dhe gjuhët e vendeve të tjera;
- demonstroi pavarësi në vendimmarrje dhe veprime.

Për të kryer detyrat që i jepen nxënësi duhet të përfshihet në veprimtari të shumta gjuhësore dhe të përdorë strategji komunikuese. Strategjitë konsiderohen si nyje lidhëse midis burimeve të nxënësit (kompetencat) dhe se çfarë ai mund të bëjë me ato (veprimtaritë komunikuese). Shumica e situatave përfshijnë llojshmëri veprimtarish dhe përdorim të më shumë se një aftësie ose shkathtësie. Për shembull në një orë mësimi, një nxënësi i kërkohet të dëgjojë shpjegimin e mësuesit, të lexojë një tekst me zë ose në heshtje, të ndërveprojë me nxënësit e tjerë në grup, të shkruajë një ushtrim ose ese madje edhe të perifrazojë, shpjegojë etj. Strategjitë janë mjeti që nxënësi përdor për të mobilizuar dhe balancuar të gjitha burimet e tij, të aktivizojë të gjitha aftësitë e tij për të përmbushur plotësisht dhe me sukses detyrat që i jepen.

2.8 Ndarja e orëve mësimore

Në tabelën e mëposhtme është dhënë koha mësimore për klasën VI, VII, VIII, IX, sipas orëve vjetore të përcaktuara në Planin Mësimor të Arsimit për fëmijët e ngjuar.

Orët Mësimore 30 javë x 1 orë/javë = 30 orë vjetore

Klasa VI, VII, VIII, IX	Formimi kulturor	Formimi gjuhësor		Puna me portofolin	Totali i orëve
		Gramatika	Funksionet gjuhësore		
	40%	30%	20%	10%	30 orë
	12 orë	9 orë	6 orë	3 orë	

Mësuesi ka të drejtë të ndryshojë deri në masën 10% të orëve të përcaktuara në tabelë duke pasur parasysh karakteristikat e çdo klase si edhe përparimin e nxënësve.

Tek orët e formimit kulturor përfshihen pjesët e reja të leximit dhe të dëgjimit të cilat përfshijnë njohuritë që merr nxënësi mbi botën e punës, shkollës, jetës personale, natyrës, udhëtimet, kulturat dhe traditat e vendeve të ndryshme etj. Nëse mësuesi vë re se disa njohuri nuk mund të përvetësohen nga nxënësi brenda një ore mësimore, ai planifikon orë rimarrje për ato njohuri.

Orët e formimit gjuhësor mbi gramatikën përfshijnë njohuritë gramatikore dhe punën me fjalorin që realizohet gjatë vitit. Këtu mund të përfshihen edhe orët e përforsimit të njohurive nëse mësuesi e shikon të nevojshme. Gjithashtu njohuritë gramatikore nuk mund të merren jashtë kontekstit dhe duke patur parasysh që përqsja në kurrikulën bërthamë është të mësuarit nëpërmjet situatave të të nxënimit, këto njohuri mund të ndërthuren edhe gjatë orëve kur fokusi është të folurit ose të shkruarit.

Funksionet gjuhësore iu referohen akteve të komunikimit që nxënësi realizon gjatë procesit të marrjes së gjuhës së huaj dhe mund të realizohen në përputhje me njohuritë dhe shkathtësitë e tjera.

Duke pasur parasysh se vlerësimi i nxënësit në klasat e mëtejshme bëhet edhe përmes përdorimit prej tij të portofolit, del si e domosdoshme që mësuesit të planifikojnë orë edhe për realizimin e projekteve dhe detyrave me portofolin e gjuhëve.

3 UDHËZIME METODOLOGJIKE

Metodat e mësimdhënies janë mjaft të rëndësishme për të realizuar një mësimdhënie efektive. Përdorimi i tyre shërben për zhvillimin gjuhësor të nxënësve dhe konsolidimin e kompetencave kyçe dhe ato të fushës.

Mësuesit duhet të përditësojnë njohuritë rreth metodave, teknikave dhe strategjive të mësimdhënies me qëllim që të zhvillojnë tek nxënësi dëshirën për dijen, virtytet njerëzore, ambicien për të qenë i suksesshëm dhe aktiv në jetën e përditshme dhe botën e punës. Metoda, strategji dhe teknika të tilla, si: diskutim për njohuritë paraprake, diagramë piramidale, lexim i drejtuar, imagjinata e drejtuar, parashikim me terma paraprake, harta e konceptit, rrjeti i diskutimit, pyetje autorit, ditaret e të nxënimit, pyetja sjell pyetjen, puna në çift ose në grup etj., shërbejnë si nxitje për nxënësin dhe si garanci për rezultate të mira në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Përqsja ndaj metodologjive të mësimdhënies dhe mësimnxënies duhet të jetë shumë e gjerë dhe të paraqesë të gjitha mundësitë në mënyrë të qartë dhe transparente duke

shmangur dogmatizmin. Mësuesi duhet të përdorë ato metoda që e ndihmojnë atë më shumë të arrijë përmbushjen e qëllimit final që është plotësimi i nevojave të nxënësit për t'u bërë një zotëruar i mirë i gjuhës.

Mësimdhënia e gjuhës së huaj karakterizohet nga kriteret e mëposhtme:

Mësimdhënie me në qendër nxënësin

Nxënësi është në qendër të procesit të mësimdhënies. Ky proces ndërtohet në varësi të nevojave, aftësive dhe interesave të nxënësit. Nxënësit e një klase nxënë në mënyra të ndryshme: disa individualisht ose në grup, të tjerë nën udhëheqjen e mësuesit, të pavarur ose me anë të mjeteve të ndryshme didaktike. Përpos kësaj, lënda 'gjuhë e huaj' kërkon që nxënësi të nxëjë konceptet, të zotërojë shprehjet dhe të zbatojë njohuritë gjuhësore. Të dyja këto kushte diktojnë nevojën për strategji të ndryshme të mësimdhënies, të cilat përshtaten me objektin e të nxënësit dhe nevojat e nxënësit. Qëllimi i çdo strategjie të mësimdhënies është që çdo nxënës të mësojë dhe të zbatojë njohuritë gjuhësore në mënyrë efektive.

Të mësuarit bashkëveprues

Mësuesit sigurojnë një mjedis të pasur dhe nxitës për komunikim dhe ndërveprim mes nxënësve. Ata përdorin metoda, strategji dhe teknika që nxisin të mësuarin bashkëveprues. Nxënësi gjatë orëve të gjuhës së huaj shpesh motivohet të punojë më nxënësit e tjerë. Detyrat e përbashkëta sigurojnë nxënësit më shumë kohë për të komunikuar dhe për të ndarë përvojat e tij me pjestarët e tjerë të grupit. Puna në grupe nxit respektin dhe tolerancën ndaj mendimit të tjetrit si dhe ndikon në përdorimin e formave demokratike për ndarjen e përgjegjësive dhe punës. Njëherazi edhe shkalla e zotërimit të gjuhës rritet duke forcuar me shumë lidhjen midis kompetencave kyçe dhe atyre të fushës.

Integrimi

Veprimtaritë gjuhësore si: të lexuarit, të shkruarit, të folurit, të dëgjuarit dhe përdorimi i drejtë i gjuhës trajtohen në mënyrë të integruar që të sigurohen lidhje kuptimplota mes tyre. Ato plotësojnë njëra-tjetrën dhe zhvillohen së bashku për t'a bërë nxënësin të aftë të komunikojë dhe të përdorë njohuritë e marra në situata të njohura dhe të panjohura për të.

Procesi i rimarrjes së njohurive

Aftësitë dhe shkathhtësitë, njohuritë rreth sistemit gjuhësor dhe llojet e ndryshme të teksteve zhvillohen duke u rishikuar çdo vit. Kjo arrihet duke kaluar nga e njohura te e panjohura dhe nga më e thjeshta te më e vështira. Temat dhe njohuritë do të rimerren në mënyrë të hollësishme dhe ciklike në faza të njëpasnjëshme të programit mësimor. Kjo mundëson që nxënësi të përparojë nga niveli bazë në nivele më të larta të përdorimit të gjuhës.

Situata e të nxënit

Mësuesi duhet të parashikojë situatë të nxëni që të realizojë gjatë një ose disa temave mësimore. Me situatë të nxëni kuptohet ndërtimi i njohurive nëpërmjet një situatë praktike ose reale. Kjo mund të zgjasë një ose disa orë mësimi. Kjo situatë ndihmon nxënësin të përdorë njohuritë e marra në jetën e tij të përditshme pa vështirësi dhe në interes të tij.

Pavarësisht metodave të përdorura mësuesi duhet të ketë parasysh që nxënësi ka fituar:

- Kompetencat e duhura
- Aftësinë për t`i përdorur këto kompetenca
- Aftësinë për të përdorur strategjitë e duhura në vënien e kompetencave në veprim

4 UDHËZIME PËR VLERËSIMIN

Vlerësimi i nxënësit është ndër komponentët më të rëndësishëm të kurrikulës me bazë kompetencat. Ky vlerësim, bazuar në rezultatet e të nxënësit, përfshin gjykimin për arritjet e nxënësit (njohuri, shkathtësi, qëndrime) përkundrejt niveleve të arritjeve.

Roli kryesor i vlerësimit është të përmirësojë të nxënësit. Informacioni i siguruar nga vlerësimi i ndihmon mësuesit të kuptojnë anët e dobëta dhe anët e forta të nxënësit në përmbushjen e kompetencave kyçe dhe ato të programit lëndor për secilën klasë, si dhe u jep mundësi të përmirësojnë mësimdhënien dhe të bëjnë propozime për përmirësimin e programeve.

Në përzgjedhjen e praktikave të vlerësimit, përcaktimin e kohës së përshtatshme për vlerësim dhe përzgjedhjen e materialeve që do të vlerësohen duhet pasur parasysh:

- përcaktimi i qëllimit dhe strategjisë së vlerësimit;
- përzgjedhja e veprimtarive që mundësojnë demonstrimin e formimit dhe konsolidimit të kompetencave;
- përdorimi i vlerësimit për të verifikuar çfarë di aktualisht nxënësi;
- besimi se të gjithë nxënësit mund t'i përmirësojnë arritjet e tyre.

Tradicionalisht, tre koncepte konsiderohen nga më themeloret në vlerësim: vlefshmëria, besueshmëria dhe të qenit vlerësim i realizueshëm.

Mësuesi duhet të ketë parasysh që në vlerësim të jetë i paanshëm dhe transparent.

Vlerësimi i nxënësit ndahet në tre tipa kryesorë:

Vlerësimi diagnostikues që zakonisht kryhet në fillim të vitit shkollor ose para zhvillimit të një grupi orësh, për të identifikuar njohuritë paraprake, interesat ose aftësitë që ka nxënësi rreth asaj për të cilën do të zhvillohet mësimdhënia gjatë vitit shkollor. Ky informacion përdoret për të orientuar praktikën e mësimdhënies dhe mësimnxënies në mënyrë që të përcaktohen strategjitë e të ardhmes. Vlerësimi diagnostikues mund të jetë i shkurtër, i shpejtë, joformal dhe mund të bëhet me gojë dhe me shkrim.

Vlerësimi formues ose i vazhdueshëm është një proces që ndodh gjatë gjithë kohës në klasë dhe informon nxënësit, prindërit dhe mësuesit mbi progresin e nxënësve. Të dhënat dhe informacioni i mbledhur nga vlerësimi formues përdoren për të përmirësuar proceset e mësimdhënies dhe të nxënësve. Fokusi i vlerësimit formues nuk duhet të jetë vetëm vlerësimi me notë i nxënësit. Ky vlerësim mund të jetë edhe me simbole, komente etj.

Vlerësimi përmbledhës ose përfundimtar kryhet më shpesh në fund të një grupi orësh, për të përcaktuar çfarë është mësuar pas një periudhe kohe. Vlerësimet përmbledhëse përdoren jo vetëm për të informuar nxënësit e prindërit për progresin e fëmijëve të tyre, por edhe për të përmirësuar praktikën e mësimdhënies dhe të nxënësve si dhe për të krahasuar arritjet me rezultatet e pritshme të të nxënësve.

Gjatë zbatimit të programit nxënësve duhet t'u jepet mundësia të punojnë individualisht, në çift ose në grup për kryerjen e detyrave të dhëna dhe përmbushjen e kompetencave të lëndës dhe atyre kyçe.

Mësuesi në klasën e tretë bën vlerësim përshkrues të arritjeve të nxënësit për aftësitë dhe shkathtësitë e tij.

Komponentët e vlerësimit janë vlerësim me gojë dhe vlerësim me shkrim. Këto vlerësime bëhen në mënyrë të alternuar me njëri-tjetrin për t'i dhënë mundësi mësuesit të bëjë një vlerësim të saktë dhe të mirëpeshuar për të gjitha veprimtaritë gjuhësore. Mësuesi, në përputhje me parimet themelore të vlerësimit, siguron përdorimin e të gjitha llojeve të vlerësimit, të cilët përcaktohen si të domosdoshëm për të gjykuar në lidhje me arritjet e nxënësve, në funksion të mbështetjes së të nxënësve dhe mësimdhënies.

Vlerësimi i punëve me shkrim është një mjet shumë i rëndësishëm i njohjes së aftësive gjuhësore të nxënësve. Praktikën e reja sot orientojnë vendosjen e kriterëve dhe të standardeve të përshtatshme dhe të arritshme nga nxënësit. Kështu, duhen kërkuar forma të larmishme vlerësimi, të cilat të pasqyrojnë nivelin real të arritjeve të nxënësve për marrjen e masave për përmirësimin e tij. Shënimet e mësuesit janë shumë të rëndësishme për vlerësimin e punëve me shkrim të nxënësve: ato duhet të jenë të tilla që t'i motivojnë ata. Vlerësimi që nxënësit mund t'i bëjnë njëri-tjetrit, është një tjetër formë e rëndësishme që ndihmon mbarëvajtjen e punës në këtë drejtim.

Vetëvlerësimi është element i rëndësishëm në mësimin e gjuhës së huaj. Vënia e synimeve të qarta në program mundëson vetëvlerësimin e tyre në vazhdimësi. Gjatë vetëvlerësimit në procesin mësimor ndiqen këta hapa:

- Mësuesi diskuton me nxënësit atë që ata do të arrijnë në klasë.

- Nxënësit vlerësojnë punën e tyre në çifte. Më pas mësuesi/ja dhe nxënësit bëjnë komentin përfundimtar.
- Nxënësit vlerësojnë punën e njëri-tjetrit në grupe duke marrë role të ndryshme, madje ndonjëherë dhe pa nevojën e ndihmës së mësuesit.
- Nxënësit mbajnë shënime arritjet e tyre duke përdorur edhe gjuhën amtare.
- Mësuesit bisedojnë me nxënësit individualisht dhe i tregojnë arritjet.
- Nxënësi cakton objektivat për të ardhmen.

Nga vetëvlerësimi përfiton si nxënësi, ashtu edhe mësuesi. Njohja e nxënësit me vetëvlerësimin e ndërgjegjëson atë të kuptojë më mirë problemet e të mësuarit dhe i jep mundësi të caktojë objektiva për të ardhmen.

Vetëvlerësimi realizohet gjatë punës me portofolin e gjuhëve.

Vlerësimi me portofol lëndor (Portofoli Europian i Gjuhëve-PEGJ)

Portofoli i nxënësit, si një mundësi vlerësimi e vetëvlerësimi, është një koleksion i punimeve të tij përgjatë vitit shkollor, kontributeve dhe arritjeve të tij në gjuhën që po mëson, kompetencat kyçe, për punën individuale dhe në grup, krijmtarinë, talentin, si dhe për aspekte të gjykimit dhe reflektimit të nxënësit për veten dhe të tjerët.

Portofoli Europian i Gjuhëve ka dy funksione: a. raportues dhe b. pedagogjik

Ai përbëhet nga tri pjesë :

- Pasaporta gjuhësore**- ku nxënësi regjistron nivelet gjuhësore, kualifikimet dhe përvojat ndërkulturore.
- Biografia gjuhësore** –ndihmon nxënësin të regjistrojë dhe të reflektojë mbi progresin e tij gjuhësor
- Dosja**- tek e cila mund të përmbajë punë me shkrim, detyra tematike, projekte lëndore e ndërlëndore, certifikata, diploma etj.

Pjesë e vlerësimit është edhe informimi i nxënësve dhe prindërve për rezultatet e vlerësimit ose për ecurinë dhe arritjet e nxënësit.

Detaje që kanë lidhje me vlerësimin gjenden në dokumente zyrtare të posaçme për vlerësimin.